

INVESTITORI
“PERLAT RECYCLING” L.L.C.

Harilaç, Fushë Kosovë

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E
MBLEDHJES, GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, TRAJTIMIT FIZIK,
RIPERDORIMIT, PËRPUNIMIT, MAGAZINIMIT TË MBETURINAVE METALIKE
NGA KOMPANIA “PERLAT RECYCLING” L.L.C., ZONA KADASTRALE HARILAÇ,
KOMUNA FUSHË KOSOVË

Fushë Kosovë, Mars – 2025

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E MBLEDHJES,
GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, TRAJTIMIT FIZIK, RIPËRDORIMIT,
PËRPUNIMIT, MAGAZINIMIT TË MBETURINAVE METALIKE NGA KOMPANIA
“PERLAT RECYCLING” L.L.C., ZONA KADASTRALE HARILAÇ, KOMUNA FUSHË
KOSOVË

Ngastra me nr. 00022-4, Zona kadastrale Harilaç, Komuna e Fushë Kosovës

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Mehmet Mujdat Inciler, Drejtor menaxhues
Investitori	“PERLA RECYCLING” L.L.C.
Adresa:	Rr Fadil Vata, Nr 44
Lokacioni i Fabrikës	Harilaç, komuna e Fushë Kosovës
Tel:	+383 44 834 128
Email:	mujdatinciler@gmail.com

Investitori:

“PERLAT RECYCLING” L.L.C.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Fushë Kosovë, Mars 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË.....	3
a)	Vendndodhja e Fabrikës.....	3
b)	Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit.....	5
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	5
d)	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse	6
e)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	7
f)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit.....	8
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	10
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	12
5.2.	Hidrografia.....	12
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	14
6.1.	Ndikimet në ajër.....	14
6.2.	Ndikimet në tokë.....	15
6.3.	Ndikimet në ujë.....	16
6.4.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	16
6.5.	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	17
6.6.	Ndikimet nga zhurma.....	17
6.7.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	17
6.8.	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat	18
6.9.	Trashëgimia Kulturore	18
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	19
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	20

9.	PERSHKRIMI I MASAVE.....	21
9.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	21
9.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	22
9.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	23
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	23
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	24
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	25
9.7.	Masat për menaxhimin e mbeturinave	25
9.8.	Masat rehabilituese	25
9.9	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	27
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	28
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	29
12.	PËRFUNDIM	30
13.	FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE	31
14.	LITERATURA E PERDORUR	32

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtirirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Fushë Kosovës.....	4
Figura 2.	Distanca e kompanisë me qytetin e Fushë Kosovës	4
Figura 3.	Distanca e kompanisë nga shtëpitë e banimi	5
Figura 6.	Makina që përdoret për presim të mbeturinave	8
Figura 7.	Rrjeti Hidrografi i Komunës së Fushë Kosovës	13

Lista e Tabelave

Tabela 1.	Tabela e kodeve që do të përdor kompania "PERLAT RECYCLING" L.L.C.	3
Tabela 2.	Furnizimi me ujë në komunën e Fushe Kosovës.....	14
Tabela 3.	Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	18

1. HYRJE

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike është një kërkesë e cila del nga Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për t'u siguruar që kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C., vepron në përputhje me standardet mjedisore të vendosura nga ligjet vendore dhe ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave. Kjo përfshin respektimin e normave për ndotjen e ajrit, kontrollin e emisioneve dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokësore. Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit mbeturinave metalike ku krijojnë potencialisht ndotës të ndryshëm që duhet të vlerësohen për ndikimin e tyre mbi ajrin, ujin dhe tokën. Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mundë të paraqiten në relacionin për qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, mbeturinave metalike nga kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C., Zona Kadastrale Harilaç, Komuna Fushë Kosovë, duke pasur parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë. Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis për qendrën e grumbullimit, seleksionimit, presimit dhe ambalazhimit të mbeturinave metalike, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit. Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është punuar duke u bazuar në kërkesën e operatorit, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania tashme ka ndërtuar objektin.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike e përdorura me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261.

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga të ndotjes burimet e palëvizshme;
- Udhëzimi administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËR KOMPANINË

Kompania “PERLA RECYCLING” L.L.C., e vendosur në Harilaç, Komuna e Fushë Kosovës. Përgatitja e vendit për fillim të punës do të realizohet pas marrjes së Pëlqimit Mjedisor, i cili është një hap i domosdoshëm për të siguruar respektimin e standardeve mjedisore dhe ligjore gjatë operimit të kompanisë. Kompania do të angazhohet në mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike. Ajo do të zbatojë praktika të avancuara në trajtimin e mbetjeve, duke siguruar që proceset të jenë në përputhje me kërkesat e larta mjedisore dhe shëndetësore. Qëllimi i kompanisë është që të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit, duke minimizuar ndikimin negativ në ambient dhe duke përmbushur normat dhe rregullat përkatëse të shëndetit publik.

Kodet të cilat do të përdor kompania janë të dhëna në tabele.

Tabela 1. Tabela e kodeve që do të përdor kompania "PERLAT RECYCLING" L.L.C.

Tabelave e kodeve të mbeturinave me të cilat do të punoj kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C.				
02 01 10	16 01 06	16 06 03*	17 04 01	17 04 07
10 03 05	16 01 17	16 06 04	17 04 02	19 10 01
15 01 04	16 01 18	16 06 05	17 04 03	19 10 02
15 01 05	16 02 16	16 06 06*	17 04 04	19 12 02
15 01 06	16 06 01*	16 08 01	17 04 05	19 12 03
16 01 03	16 06 02*	16 08 03	17 04 06	20 01 40

a) Vendndodhja e Fabrikës

Objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, të mbeturinave metalike, do të ndërtohet në ngastrën k adastrale me nr. 00022-4, Zona kadastrale Harilaç, komuna e Fushë Kosovës.




Figura 1. Shtrirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Fushë Kosovës

Qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, të mbeturinave metalike, ndodhet 11.8 km largët nga komuna e Fushe Kosovës. Të gjitha objektet te cilat janë afër kësaj qendre janë objekte me aktivitete industriale, siç janë: JYSK, Kosmonte Foods, Papperlapapp, EnvriCon, Eu Beton, etj., afër ka edhe gastronomi e cila është në distance 309 m ndërsa me shtëpi banimi 340m etj.




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Fushë Kosovës




Figura 3. Distanca e kompanisë nga shtëpitë e banimi

b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit

Faza operative e qendrës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike nga kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C. është e vendosur në Zonën Kadastrale Harilaç të komunës së Fushë Kosovës. Ky projekt përfshin disa veçori kryesore, të cilat janë thelbësore për funksionimin e efektshëm të qendrës.

Objekti kryesor i projektit është depo montazh, e cila do të ndërtohet me konstruktive metalike. Ky objekt do të përdoret për instalimin dhe vendosjen e pajisjeve të nevojshme për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave metalike. Konstruksioni metalik do të ofrojë qëndrueshmëri dhe siguri, duke mundësuar mbajtjen e pajisjeve dhe mekanizmave të specializuar që janë të nevojshme për operacionet e përditshme të qendrës. Kjo strukturë është projektuar për të akomoduar proceset e ndryshme industriale dhe logjistike, duke garantuar që materialet të trajtohen sipas standardeve të përcaktuara dhe në mënyrë të sigurt.

Kjo fazë operative përfshin gjithashtu aspektet e trajtimit fizik dhe ripërdorimit të mbeturinave metalike, të cilat do të përpunohen dhe magazinohen në mënyrë të organizuar, duke siguruar efikasitet dhe respektim të rregulloreve mjedisore.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit të qendrës për mbledhje, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike përfshin disa procese kryesore që synojnë përpunimin e mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Kjo fazë është thelbësore për transformimin e materialeve të grumbulluara në produkte të tjera të gatshme për

ruajtje, transport, magazinim, ripërdorim, duke reduktuar ndotjen dhe duke siguruar menaxhim të sigurt të materialeve. Proceset e fazës operative përfshijnë: grumbullimin e mbetjeve nga burime të ndryshme, seleksionimin për ndarjen e metalit dhe përpunimin e metalit për t'i bërë ato të gatshme për presim, presimin për uljen e vëllimit dhe krijimin e formave të menaxhueshme, dhe ambalazhimin për ruajtjen dhe transportimin e sigurt të materialeve. Në këtë fazë, përdoren teknologji dhe makineri moderne për të siguruar efikasitetin e procesit dhe për të minimizuar ndikimet negative në mjedis, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe të ndikimeve mjedisore. Kjo fazë operon gjithashtu për të siguruar që mbeturinat të ruhen dhe transportohen në përputhje me rregulloret mjedisore, duke kontribuar në menaxhimin efikas të mbetjeve.

d) Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Në kontekstin e projektit për grumbullimin, seleksionimin, presimin dhe ambalazhimin e mbeturinave metalike, lënda e parë dhe lënda ndihmëse përfshijnë materialet dhe burimet që janë të nevojshme për të realizuar proceset e përpunimit të mbetjeve dhe për të siguruar operimin efikas të qendrës.

Lënda e parë në këtë projekt përfshin:

1. Mbeturinat Metalike

Kjo kompani lenden e pare do ta siguroj përmes tenderëve nga korporatat e mëdha dhe kompani te ndryshme, si p.sh. Keku, Feronikeli etj.

Grumbullimi i këtyre materialeve është faza e parë e procesit dhe ato përbëjnë lëndën e parë për fazat e mëtejshme të seleksionimit, presimit dhe ambalazhimit. Lënda ndihmëse për këtë projekt përfshin materiale dhe burime që përdoren për të mbështetur procesin e operimit dhe për të siguruar efikasitetin dhe sigurinë gjatë përpunimit të mbetjeve.

Këtu përfshihen:

1. Energjia elektrike
2. Uji
3. Pajisje mbrojtëse – për punonjësit, si doreza, maska dhe veshje mbrojtëse që sigurojnë mbrojtjen gjatë operacioneve të përpunimit të mbeturinave.

Këto lëndë ndihmëse janë thelbësore për përmbushjen e kërkesave teknologjike dhe mjedisore të projektit, duke mundësuar përpunimin efikas dhe të sigurt të mbeturinave.

e) Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike ka për qëllim të menaxhojë mbeturinat në mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në mjedis dhe të sigurojë trajtim të sigurt në përputhje me normat mjedisore. Prosesi teknologjik përfshin disa faza të rëndësishme që garantojnë menaxhimin efikas dhe të qëndrueshëm të këtyre mbetjeve.

- **Grumbullimi i Mbeturinave**

Faza e parë e procesit të menaxhimit të mbeturinave metalike përfshin grumbullimin e materialeve nga burime të ndryshme, përfshirë institucione shëndetësore, fabrika, dhe grumbullues të tjerë. Ky proces kërkon përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të specializuara, të tilla si kamionë dhe transportues të tjerë të përshtatshëm, të cilët sigurojnë ruajtjen e sigurt të materialeve gjatë mbledhjes dhe transportimit, duke minimizuar mundësitë e ndotjes dhe dëmtimit të mbeturinave. Organizimi dhe logjistika e grumbullimit janë të rëndësishme për optimizimin e efikasitetit, ku çdo material mbledhet dhe transportohet në përputhje me kërkesat e specifikave të tij. Pas grumbullimit, mbeturinat dërgohen për seleksionim, ku ato ndahen në kategori të ndryshme sipas llojit të materialeve që përmbajnë. Ky proces është thelbësor për sigurimin e trajtimit të duhur të çdo lloji materiali dhe për përgatitjen e tij për fazat e mëtejshme.

- **Seleksionimi i Mbeturinave**

Seleksionimi është një fazë thelbësore në procesin e menaxhimit të mbeturinave metalike, pasi ndihmon në ndarjen e materialeve të ndryshme për trajtim specifik dhe mundëson reduktimin e ndikimeve mjedisore. Mbeturat ndahen në mënyrë manuale. Ky proces përfshin identifikimin dhe ndarjen e metaleve të ndryshme, siç janë çeliku, alumini, bakri, të cilat dërgohen për trajtim dhe përpunim të mëtejshëm. Mbeturat metalike trajtohet me teknologji të specializuara për të arritur nivele të larta të efikasitetit.

- **Presimi i Mbeturinave**

Presimi i mbeturinave është një proces i rëndësishëm në menaxhimin e mbeturinave metalike, që ka për qëllim të zvogëlojë volumnin e materialeve dhe të përmirësojë efikasitetin e ruajtjes dhe transportit të tyre. Ky proces realizohet duke përdorur makineri presimi, të cilat kompresojnë mbeturinat metalike në forma të ngjeshura, siç janë blloqet, që mund të jenë më të lehta për të ruajtur dhe transportuar. Presimi ndihmon gjithashtu në reduktimin e hapësirës së nevojshme për magazinim, duke mundësuar një menaxhim më të mirë të hapësirave dhe duke rritur kapacitetin për ruajtjen e materialeve. Pas presimit, materialet e kompresuara janë më të lehta për t'u transportuar në destinacionet për përpunim të mëtejshëm. Ky proces është

gjithashtu thelbësor për të siguruar që mbeturinat metalike të ruhen në kushte të sigurta, duke parandaluar dëmtimin e materialeve gjatë manipulimit dhe transportimit. Në figurë është paraqitur një model i pajisjes që do të përdoret për presim të mbeturinave metalike.



Figura 4. Makina që përdoret për presim të mbeturinave

- **Ruajtja dhe Transporti i Mbeturinave**

Mbeturinat e trajtuara ruhen dhe transportohen për trajtim të mëtejshëm, duke siguruar mbrojtjen e materialeve dhe menaxhimin e tyre të sigurt. Mbeturinat do të ruhen në depo të sigurta, të cilat janë të projektuar për të mbajtur materialet të pastra dhe të paprekura nga ndotësit e mundshëm. Kjo depo është e mbrojtura nga faktorët e jashtëm që mund të shkaktojnë kontaminim dhe janë të dizajnuara për të parandaluar ndikimet mjedisore negative. Transporti i mbeturinave pas ruajtjes është gjithashtu një element kyç i procesit, i cili realizohet me mjete të specializuara që sigurojnë transportimin e sigurt dhe efikas të materialeve deri në destinacionet përkatëse. Procesi teknologjik i grumbullimit, seleksionimit, presimit dhe ambalazhimit të mbeturinave është i organizuar me qëllim të sigurimit të një përpunimi të qëndrueshëm dhe të sigurt të materialeve. Aktivitetet e kësaj qendre janë të dizajnuara për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe për të mundësuar një menaxhim efikas të mbetjeve. Përdorimi i teknologjive moderne dhe metodave të qëndrueshme është në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit, duke siguruar një balancë të duhur midis efikasitetit industrial dhe ruajtjes së burimeve natyrore.

f) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Përlllogaritja e sasisë së mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit të qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit,

magazinimit të mbeturinave metalike nga "PERLAT RECYCLING" L.L.C. është një proces i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe për vlerësimin e ndikimeve mjedisore. Kjo përlllogaritje do të ndihmojë në përcaktimin e volumit të mbetjeve dhe emetimeve që do të gjenerohen, si dhe në hartimin e strategjive për uljen e ndikimeve mjedisore.

Ajër: Faza operative e mbledhje, grumbullimin, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike mund të shkaktojë emetime në ajër për shkak të proceseve si transporti, përdorimi i makinerive industriale dhe presimi i materialeve. Emisionet kryesore përfshijnë dioksidin e karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x), pluhurin dhe gazrat si metan. Transporti i mbetjeve dhe përdorimi i makinerive përpunuese janë burimet kryesore të ndotjes. Lëshimi i pluhurit janë gjithashtu shqetësime për cilësinë e ajrit. Për të reduktuar ndikimet, është e nevojshme të përdoren teknologji efikase dhe masat për kontrollin e emetimeve. Monitorimi dhe menaxhimi i duhur do të ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Ujë: Faza operative e qendrës për mbledhje, grumbullimin, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike mund të ndikojë në cilësinë e ujit përmes mundësisë së derdhjes së karburanteve nga mjetet e transportit që mund të depërtojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Masat për minimizimin e ndikimeve përfshijnë përdorimin e mbrojtjes për të parandaluar derdhjen, si dhe implementimin e sistemeve për trajtimin e ujit të përdorur dhe ruajtjen e kushteve higjienike gjatë operacioneve.

Dheu: Gjatë fazës operative të qendrës për mbledhje, grumbullimin, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike, ndikimet në tokë mund të ndodhin si rezultat i derdhjes së substancave të dëmshme si vajra dhe materialeve të tjera nga mbeturinat. Këto substanca mund të depërtojnë në tokë, duke shkaktuar ndotje. Po ashtu, procesi i pastrimit dhe lëvizjes së mbeturinave mund të shkaktojë ndotje të tokës, duke ndikuar në biodiversitetin dhe stabilitetin e ekosistemit.

Zhurma: gjate operimit mund të ketë zhurmë gjate lëvizjes se makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjatë operimit është minimale.

Flora dhe Fauna: Në rast se kemi derdhje apo shkarkim nga ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Ndikimet në florë dhe faunë janë minimale.

Ndikimet sociale dhe ekonomike: mund të themi lirisht se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Duke e pasur parasysh se hapësira ku do të ndërtohet qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike “PERLAT RECYCLING” L.L.C. është përzgjedhur në atë mënyrë që të jetë sa me afër lëvizjeve të shumta të makinerive dhe po ashtu të ruaj shëndetin e njeriut.

Me poshtë do ti paraqesim disa alternativa të arsyeshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe shoqëri:

- **Zgjedhja e Zonave:** Zgjedhja e lokacioni është bërë në zonë industriale me infrastrukturë të zhvilluar, ku është e mundur të lidhet lehtësisht me burime të tjera si energjia dhe uji.

Përparësitë:

- Këto zona zakonisht ofrojnë rrjete të mira transporti, të cilat janë thelbësore për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e produkteve.
- Këto zona shpesh kanë afërsi me burime të tjera si energjia dhe uji. Kjo është e rëndësishme për funksionimin e pandërprerë të proceseve të grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave.
- Një zonë me industri të ngjashme ofron mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe burimeve, duke stimuluar inovacionin dhe optimizmin e proceseve. Kjo mund të çojë në përmirësimin e efikasitetit dhe uljen e kostove..

Mangësitë:

- Aktivitetet industriale të tjera në zonë mund të rrisin ndotjen e ajrit dhe ujit, duke ndikuar në cilësinë e produktit.
- Nëse ka shumë fabrika të tjera që operojnë në të njëjtën zonë, mund të krijohet një konkurrencë e madhe që do të vështirësojë mbajtjen e çmimeve konkurruese dhe rritjen e kapaciteteve të fabrikës.

- **Qasja e Mirë:** Lokacioni në Fushë Kosovë ofron qasje të shkëlqyer në rrugët dhe infrastrukturën e transportit, një faktor kyç për një operacion efikas të qendrës.

Përparësitë:

- Qasja në rrugët kryesore mund të zvogëlojë kostot e transportit të materialeve dhe shpërndarjen e produkteve. Kjo është e rëndësishme për një qendër që merret me grumbullimin dhe shpërndarjen e mbeturinave dhe produkteve të tjera.
- Lehtësitë për transportin e shpejtë dhe të sigurt mes impiantit dhe tregjeve ndihmojnë për të rritur efikasitetin dhe shërbimin ndaj klientëve.

Mangësitë:

- Në periudha të pikut, rrugët mund të jenë të ngarkuara, duke shkaktuar vonesa dhe ndikime negative në operacionet e ditore. Kjo mund të dëmtojë efikasitetin dhe mund të rrisë kostot operative.
- Rritja e aktivitetit industrial në zonë mund të kërkojë investime të mëtijshme për menaxhimin e trafikut dhe sigurimin e sigurisë, si dhe për të ruajtur fluksin normal të operacioneve.

➤ **Burime Të Tjera:** Lokacioni ofron akses të lehtë në burime të tjera si energjia elektrike dhe ujë, që janë të domosdoshme për funksionimin e qendrës së grumbullimit të mbeturinave.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të energjisë afër mund të sjellë kosto më të ulëta operative dhe një furnizim të qëndrueshëm energjie për qendrën e grumbullimit të mbeturinave. Ky furnizim i vazhdueshëm është thelbësor për proceset e përpunimit të mbeturinave.

Mangësitë:

- Çdo problem me furnizimin e energjisë mund të ndikojë drejtpërdrejt në operacionet e qendrës së grumbullimit të mbeturinave, duke sjellë vonesa dhe humbje financiare. Ajo mund të kërkojë një investim të madh për përmirësimin e infrastrukturës energjetike, nëse burimet nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm.
- Nëse burimet aktuale nuk janë të mjaftueshme ose nuk janë zhvilluar mirë, mund të kërkojë investim shtesë për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas.


Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C nuk e ka pasur të vështirë të merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për qendrën mbledhje, grumbullimin, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave metalike. Kompania e ka parë të rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kanë kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë “PERLAT RECYCLING” L.L.C. Andaj duke i marrë parasysh të gjitha alternativat e mësipërme është përzgjedhur lokacioni i kompanisë “PERLAT RECYCLING” L.L.C., e cila ka qasje në rrugën, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit është si rezultat i zhvillimit të pakontrolluar në sektorët industrialë dhe urbanë, planifikimit joadekuat të pajisjeve industriale dhe urbane, teknologjisë së vjetër industriale, teknologjisë joadekuate në disa departamente industriale të resurseve natyrore, infrastrukturës joadekuate në qytete, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e rrjedhave të ujit për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, akumulimi i plehrave urbane dhe të ngurta industriale, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni i dheut dhe aktivitetet e tjera të njeriut. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga ndotja e madhe që vjen nga ndotësit lokal por edhe nga ndotësit e mëdhenj në komunat fqinje si Termoelektranat dhe Ferronikeli. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga zhvillimi i paplanifikuar, duke respektuar kornizën për zhvillim hapësinor të propozuar me planin zhvillimor, me qëllim të arritjes së shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të pasurive të mjedisit. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, me peisazhin dhe trashëgiminë natyrore paraqet një burim të rëndësishëm për komunën i cili duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit. Monumentet natyrore e kulturore duhet të trajtohen si trashëgimi kombëtare dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Vend me potencial turistik paraqet pejsazhi i pyjeve në Sllatinë të Vogël, Harilaq dhe në Bardh të madh. Po ashtu si vend piktoresk mund do jetë në te ardhmen edhe liqeni i peshqve në Henc. (Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis, 2009). Mbrojtja e mjedisit nga ndotja është një prioritet për komunën e Fushë Kosovës duke pasur parasysh shkallën e madhe të ndotjes në vend dhe rajon. Ndotja e ajrit është evidente, dhe përpos trafikut të automjeteve dhe industrisë lokale ndotje të madhe shkaktojnë Termoelektranat në Obiliq si dhe Ferronikeli në Drenas. Po ashtu nga mbetjet e prodhimeve industriale dhe nga mbeturinat ndotet edhe uji në komunën e Fushë Kosovës. Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e ajrit dhe zhurma, vibracionet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

5.2. Hidrografia

Resurset kryesore të ujërave sipërfaqësore në komunën e Fushë Kosovës janë lumenjtë Sitnica, Drenica, Graçanka dhe Prishtina. Këta lumenj degëzohen në territorin e kësaj komune. Disa nga përrockat më të rëndësishme që rrjedhin në këtë komunë janë Gjelbazaku dhe Zanoga. Sitnica është lum i njohur në Kosovë dhe është dega kryesore e lumit Ibër. Ky lum dallohet nga të tjerët jo vetëm për shkak të madhësisë së pellgut (2.861 km²), por gjithashtu për shkak të



Në Territorin e Fushë Kosovë është i vendosur edhe një stacion hidrometrik që i takon rrjetit hidrometrik të Kosovës me 22 stacione matëse, të vendosura nga Instituti Hidrometrologjik i Kosovës.

Momentalisht në komunën e Fushë Kosovës ekzistojnë 21 burime të ujit që shfrytëzohen për prodhimin e ujit të pijshëm. Të gjitha këto sisteme për furnizim me ujë shfrytëzojnë ujërat nëntokësore.

Tabela 2. Furnizimi me ujë ne komunën e Fushe Kosovës

Burimi	Lloji i burimit	Kapaciteti (l/s)	Prodhiimi në 2009 (m ³)	Menaxh.
Kroni – Kuzmin	12 puse	150 l/s	2,918,508	KUR
Vragoli	6 puse	60 l/s	Fillon në shtator 2011	KUR
Henc	1 pus	5 l/s	Nuk ka të dhëna	Komuniteti Lokal
Miradi e Ulët	1 pus	20 l/s	Fillimi i punës në qershor 2011	KUR
Kroni i Spahisë -Harialaq	1 pus	5 l/s	Nuk ka të dhëna	Komuniteti Lokal

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e mënyrave se si aktivitetet e ndryshme industriale, si ato të “PERLAT RECYCLING” L.L.C, ndikojnë në ambient. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku do të ndërtohet objekti të cilin e shfrytëzon kompania “PERLAT RECYCLING” L.L.C. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1. Ndikimet në ajër

Ndikimet në ajër që mund të vijnë nga operimi i qendrës që merret me mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike mund të përfshijnë një gamë të gjerë gazrash dhe grimcash që ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit dhe mund të kenë pasojë për shëndetin e punonjësve dhe mjedisin

në përgjithësi. Këto ndikime janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet industriale dhe logjistikën që zhvillohen brenda qendrës. Transporti i mbeturinave metalike dhe materialeve të tjera nëpërmjet mjeteve të transportit që përdorin karburante fosile mund të lëshojë CO₂, okside azoti (NO_x) dhe grimca të imta. Këto emisione janë kontribues në ndotjen e ajrit dhe kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe ndikojnë negativisht në ndryshimet klimatike. Gjatë ngarkimit dhe transportimit të mbeturinave metalike, mund të krijohet pluhur dhe grimca të imta që lëshohen në ajër. Gjatë proceseve të përpunimit të metaleve (si presimi, grumbullimi dhe seleksionimi), krijohet një sasi e madhe pluhuri dhe grimcash të imta që mund të lëshohen në ajër. Këto grimca mund të përmbajnë elemente të rrezikshme për shëndetin, si metale të rënda, dhe mund të shkaktojnë ndotje të ajrit. Mbeturinat metalike të grumbulluara dhe të depozituara mund të lëshojnë substanca të ndryshme në ajër, veçanërisht nëse ato janë të kontaminuara ose përmbajnë substanca të dëmshme. Pjesë të pluhurit dhe grimcave të metaleve të rënda mund të lëshohen në ajër gjatë manipulimit dhe magazinimit të mbeturinave, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ajrit.

Nëse mbeturinat metalike ruhen në kushte që mund të shkaktojnë dekompozim ose korrozion të materialeve, mund të krijohen gazra të dëmshëm që ndotin ajrin. Kjo është veçanërisht e mundur në rastet kur metali është i përzier me substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të lëshojnë gazra toksikë.

6.2. Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë që mund të vijnë nga operimi i qendrës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike mund të jenë të ndryshme dhe kanë potencial për të shkaktuar ndotje dhe dëmtim të qëndrueshëm të tokës dhe mjedisit përreth. Mbeturinat metalike përmbajnë shpesh metale të rënda si plumb, kadmium, merkur, dhe arsenik, të cilat janë toksike për ekosistemet dhe mund të depërtojnë në tokë. Këto substanca mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e tokës, duke çuar në ndotje që mund të dëmtojë bimësinë dhe biodiversitetin lokal. Gjatë përpunimit dhe ripërdorimit të mbeturinave metalike, mund të ndodhin lëshime të substancave kimike të dëmshme që mund të depërtojnë në tokë. Kjo mund të ndodhë nga depozitimi i materialeve të kontaminuara në toka, sidomos nëse mbeturinat përmbajnë kimikate të dëmshme ose substanca që mund të ndikojnë në aciditetin dhe shëndetin e tokës. Kur mbeturinat metalike ruhen në kushte që favorizojnë korrozionin, metali mund të shkrijë ose të lëshojë substanca të dëmshme, të cilat mund të depërtojnë në tokë dhe të ndotin sipërfaqen e saj. Nëse mbeturinat depozitohen

në mënyrë të pasigurt, ato mund të krijojnë shtresa mbeturinash që pengojnë penetrimin e ujit në tokë, duke kufizuar aftësinë e tokës për të mbajtur lagështirë dhe për të mbështetur jetën bimore. Përdorimi i pajisjeve të rënda për të transportuar dhe grumbulluar mbeturina metalike mund të shkaktojë kompresim të tokës dhe dëmtim të strukturës së saj, duke rritur mundësinë e erozionit dhe zvogëluar aftësinë e tokës për të ruajtur lagështirën. Gjatë proceseve të presimit dhe ambalazhimit, mund të krijohet pluhur i dëmshëm që përmban substanca toksike. Ky pluhur mund të depërtojë në tokë dhe të ndikojë në strukturën dhe cilësinë e saj. Nëse mbeturinat e grumbulluara nuk depozitohen dhe trajtohen siç duhet, ato mund të shkaktojnë kontaminim të vazhdueshëm të tokës dhe ujërave të afërta.

6.3. Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë që mund të vijnë nga operimet e qendrës që merret me mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike mund të jenë të rëndësishme dhe kanë potencial për të ndikuar negativisht në cilësinë e ujërave. Mbeturinat metalike, sidomos ato që përmbajnë metale të rënda si plumb, kadmium, mercuri, arsenik dhe krom, mund të lëshojnë substanca toksike në ujë. Këto metale të rënda mund të depërtojnë në burimet ujore përmes shkarkimeve të paplanifikuara ose derdhjeve aksidentale, duke ndotur ujin. Pluhuri dhe grimcat e metaleve që krijohen gjatë proceseve të seleksionimit, presimit dhe përpunimit të mbeturinave metalike mund të shpërndahen në ujë përmes erozionit apo lagështirës që rrjedh nga proceset e trajtimit. Lëngjet dhe substancat kimike që lëshohen gjatë procesit të grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave mund të arrijnë në ujërat sipërfaqësore (lumenj, liqene) dhe nëntokësore përmes rrjedhjes sipërfaqësore ose infiltrimit nëntokësor. Ky kontaminim mund të jetë vazhdueshëm dhe të përhapet në zona të gjera, duke e bërë ujin të papërdorshëm dhe duke rritur rrezikun e ndotjes të vazhdueshme. Gjatë procesit të grumbullimit dhe seleksionimit, mund të lëshohen pluhur dhe substanca kimike që shpërndahen në ajër dhe që mund të depërtojnë në ujërat afër.

6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë që mund të vijnë nga operimet e qendrës që merret me mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin dhe magazinimin e mbeturinave metalike mund të jenë të ndjeshme dhe të shumëfishta, duke përfshirë ndryshime. Zhvillimi industrial mund të ketë sjellë shkatërrimin e habitatit për shumë specie bimore, duke kufizuar rritjen e tyre dhe duke reduktuar diversitetin biologjik. Ndryshimet në peizazh mund të krijojnë kushte që lehtësojnë shfaqjen e specieve invazive, të

